

Zhvillimi i internetit si pjesë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përdorimi i platformave sociale on line dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Dr. Alket Jaupi

Ekspert në Institucionin e Avokatit të Popullit,

alketjaupi2@gmail.com

Abstrakt

Në ditët e sotme, interneti dhe rrjetet sociale janë dy koncepte të ndërlidhura që kanë transformuar mënyrën si [komunikojmë](#), lidhemi dhe informohemi në botën moderne. Qëllimi i krijimit dhe përdorimit të rrjeteve sociale, është përdorimi i tyre si [platforma online](#) që lejojnë përdoruesit të ndajnë përmbajtje të caktuara, të lidhen me përdorues të tjerë, si dhe të krijojnë dhe të shpërndajnë përmbajtje të ndryshme. Efektivisht, zhvillimi i kësaj teknologjie informacioni dhe komunikimi on line, mundëson ndërveprimin e përdoruesve të rrjeteve sociale me njëri-tjetrin, në një ambient virtual, duke ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve dhe funksioneve.

Në këtë kontekst, interneti është bërë një medium i rëndësishëm komunikimi që ka vepruar si katalizator për ushtrimin e lirive themelore të njeriut, siç edhe liria e shprehjes dhe e informacionit. Jo vetëm kjo, por përdorimi i rrjeteve sociale ka krijuar shpesh diskutime për një hapësirë të re digjitale që nxit ndërveprimin e ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në këtë punim, analiza e zhvillimeve që lidhen me marrjen e masave kufizuese për përdorimin e rrjeteve sociale në vendin tonë, synon të sjellë një këndvështrim specifik mbi raportin e drejtë që duhet të këtë përdorimi i rrjeteve sociale on line, me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Keywords: *rrjete sociale, liria e shprehjes, të drejta dhe liri të tjera, kufizim, proporcionalitet.*

1. Hyrje

Liria e shprehjes është një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe një gur themeli,⁷¹ mbi të cilin ngrihet vetë ekzistenca e një shoqërie demokratike.

Përpos legjislacionit në fuqi që garanton lirinë e shprehjes, por edhe të drejta e liri të tjera themelore që ndërveprojnë me të, një rol të rëndësishëm për kuptimin dhe mbrojtjen e kësaj lirie themelore ka luajtur edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në të cilën theksohet se, "... liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm,

⁷¹ Liria e shprehjes është afirmuar herët në vende si Anglia, që e ka legjitimuar të drejtën e shprehjes që në vitin 1689, apo Franca, që gjatë revolucionit francez, e ka njohur këtë liri në Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarëve, ndërkohë që në vitin 1789, u specifikua se e drejta e shprehjes është e detyrueshme me ligj. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, amendamenti i parë i krijuar në mbrojtje të lirisë së shprehjes, daton në vitin 1791. Në një kuadër ndërkombëtar neni 19, i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, përcakton qartë se: "*Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes...*".

tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre, pushteti shtetëror bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtash dhe lirish të tjera themelore⁷².

Përdorimi i **rrjeteve sociale** si një **hapësirë e re për ushtrimin e lirisë së shprehjes**, ka krijuar një **raport të ri, kompleks dhe dinamik** ndërmjet tyre dhe **lirisë së shprehjes**. Në këtë kontekst, rrjetet sociale kanë **zhvendosur praktikisht fushën e lirisë së shprehjes, nga sfera publike tradicionale në një mjedis dixhital**.

Rrjetet sociale përbëjnë sot një nga zhvillimet më të rëndësishme në fushën e komunikimit dhe të drejtave të njeriut, por përdorimi i tyre kërkon vendosjen e një balance të drejtë midis lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të tjera legjitime të individit. Numri i aktorëve dhe i platformave të komunikimit dhe të informimit në vend është shumëfishuar. Kanë ndryshuar gjithashtu edhe mënyrat e prodhimit, konsumimit dhe të shpërndarjes së informacionit. Krahas mediave tradicionale, një rol gjithnjë e më të madh në procesin e informimit të publikut po marrin edhe mediat sociale. Mediat sociale po paraqiten si kanale të reja të lidhjes me audiencën dhe të shpërndarjes së përmbajtjes, së prodhuar nga vetë përdoruesit dhe publiku i gjerë.

Përdorimi i rrjeteve sociale sot është shumë i përhapur dhe prek pothuajse çdo sferë të jetës. Subjektet që i përdorin këto platforma janë të shumta dhe të ndryshme, dhe në to përfshihen **“Individët”, të rinj dhe të rritur, si përdorues të zakonshëm**, me qëllim argëtimi, vetëshprehjeje, ndjekjeje tendencash, dhe komunikimi me miqtë. Të **rriturit** po i përdorin gjithnjë e më shumë rrjetet sociale për informacion, marketing personal, ndarjen e përvojave, apo për të ndjekur influencues të ndryshëm. **“Influencuesit dhe krijuesit e përmbajtjes”, janë një kategori tjetër subjektësh (këtu përfshihen edhe artistët, sportistët, kuzhinierët, grimierët, komedianët e deri te ekspertët e fushave të ndryshme), të cilët nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale krijojnë përmbajtje për ndjekësit e tyre dhe shpesh bashkëpunojnë me marka për promovim produktësh dhe shërbimesh.**

Përdorues të rrjeteve sociale janë edhe **“Institucionet dhe organizatat”,** kuptuar këtu institucionet publike, të cilat qëllimjnë informimin e qytetarëve për veprimtarinë e tyre, shpërndarjen e lajmeve, kryerjen e fushatave të ndërgjegjësimit, si dhe organizatat joqeveritare, të cilat e qëllimjnë përdorimin e rrjeteve sociale për fushata edukimi, ndërgjegjësimi dhe mbledhje fondesh.

“Mediat dhe portalet informative” si subjekte (kuptuar këtu gazetarët dhe profesione të tjera që lidhen me median), nëpërmjet rrjeteve publike, publikojnë lajme, video të shkurtra informative, apo argëtuese për të tërhequr audiencë të re, veçanërisht të rinjtë. Po kështu, **“Artistët dhe figurat publike - Këngëtarë, aktorë, politikanë, sportistë”,** përdorin rrjetet sociale për të ndërtuar markën personale, për të qenë më afër publikut, apo për të promovuar projektet e tyre. Gazetarët dhe mediat tradicionale të zhvendosur në rrjetet sociale i shfrytëzojnë ato jo vetëm si mjet i gjerë komunikimi, por edhe si mjet apo burim financiar, për të fituar të ardhura nëpërmjet publikimit, e shpërndarjes së lajmeve dhe reportazheve.

Një kategori e veçantë e subjekteve që përdorin rrjetet sociale janë edhe **“Bizneset dhe kompanitë”.** Përdorimi nga ana e tyre i rrjeteve sociale, bëhet për qëllime **marketingu,**

⁷² Shih vendimin nr. 21, datë 22.04.2025, (paragraf 42), të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si dhe vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 56, datë 27.07.2016; nr. 16, datë 11.11.2004, të po kësaj gjykatë.

promovimi të produkteve dhe komunikimi me klientët. Edhe bizneset e vogla gjithashtu përdorin rrjetet sociale për të ndërtuar imazhin e tyre dhe për të shitur në mënyrë direkte. Pra, siç edhe rezulton rrjetet sociale janë kthyer në mjete kryesore për **ndikim kulturor, marketing dhe informim.**

Aksesi në internet tashmë konsiderohet si një e drejtë e njeriut, ndaj edhe në legjislacionin tonë në fuqi garantohet aksesi në internet. Por edhe ky akses mund të kufizohet, për të mbrojtur sigurinë kombëtare, nxitjen e terrorizmit, shëndetin publik, gjendjet e emergjencave civile, ndalimin e materialeve me përmbajtje kriminale, pornografi për të miturit, raciste, ksenofobike dhe të gjuhës së urrejtjes, mbrojtjen e të dhënave e personale, privatësisë, etj. Kufizimi i aksesit, do të thotë kufizim i përdorimit të internetit nga ana e përdoruesve të tij, si në kuptim të marrjes së informacionit që mund të gjendet i ruajtur në të, ashtu edhe të publikimit të informacionit individual përmes tij.

Kufizimi i aksesit, apo mbyllja e rrjeteve sociale mund të kenë ndikime të drejtëpërdrejta në cenimin e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen e lirisë së veprimtarisë ekonomike të subjekteve të ndryshme, të cilët përdorin rrjetet sociale si mjet kryesor për marketing, shitje dhe komunikim me klientët. Pra, *prima facie* gjasat janë që cenimi i lirisë së shprehjes nëpërmjet mbylljes, apo kufizimit të përdorimit të rrjeteve sociale, cenon drejtëpërdrejtë lirinë ekonomike, duke reduktuar mundësitë e tregtisë, inovacionit, llogaridhënies dhe konkurrencës së ndershme, për ata përdorues të rrjetit social, të cilët e përdorin këtë rrjet për të ushtruar të drejta dhe liri që përmbahen në konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Kjo pasi, në një mjedis ku informacioni është i kufizuar, premiset janë që ekonomia të bëhet më e centralizuar, më pak dinamike dhe më pak e drejtë.

Çdo cenim, apo kufizim i lirisë së shprehjes në kushtet e ndërveprimit të ndërsjelltë dobiprurës me lirinë e veprimtarisë ekonomike, i konstatuar në kushtet e një ndërhyrjeje aktive nga ana e shtetit, duhet të kryhet në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Garantimi dhe kufizimi i lirisë së shprehjes

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes, si një nga liritë themelore të njeriut dhe si një shtyllë të rëndësishme të demokracisë, duke dhënë garancinë ndaj çdo individi për të shprehur lirshëm mendimet, opinionet dhe informacionin, si në mënyrë individuale, ashtu edhe përmes mjeteve të komunikimit masiv.⁷³

Shqipëria është vend palë në disa disa instrumenta të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare, që kanë për qëllim të garantojnë një mjedis të lirë, të sigurt dhe pluralist për komunikimin publik, dhe që vendosin një standard minimal për mbrojtjen e lirisë së medias. Më konkretisht, **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,** parashikon se e drejta e lirisë së shprehjes është një e drejtë e afirmuar dhe se ajo përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.⁷⁴ Në paragrafin e parë të nenit 10, të Konventës

⁷³ Në nenin 22, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjetit të komunikimit ndalohe.
4. Ligji mund të kërkojë autorizim për funksionimin e stacioneve të radios dhe televizionit.

⁷⁴ Në nenin 10, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, parashikohet se:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televizion ose kinematografik të pajisen me licencë.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të

Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikohet se: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë”. Në këtë kuptim, liria për të dhënë informacion dhe mendime është një komponent shumë i rëndësishëm i lirisë së shprehjes, për jetën dhe demokracinë e një vendi.

Liria e shprehjes e sanksionuar në paragrafin 1, të nenit 10, të kësaj konvente përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet themelore për përparimin e saj.⁷⁵

Një tjetër instrument i rëndësishëm ndërkombëtar për afirmimin e lirisë së shprehjes është **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i hartuar në** përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara.⁷⁶ Rezoluta 428 (1970), e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, plotëson këtë kuadër instrumentash ndërkombëtarë duke afirmuar se e drejta për lirinë e shprehjes, “...përfshin të drejtën për të kërkuar, marrë, dhënë, për të bërë publike ose për të shpërndarë informata të interesit publik”. Në këtë rezolutë thuhet se media ka detyrën të shpërndajë informacion të përgjithshëm dhe të plotë për çështjet e interesit publik. Për më tepër, autoritetet publike duhet të bëjnë të aksesueshëm, në kushte të arsyeshme, informacionin e interesit publik.

Në legjislacionin e brendshëm në fuqi në vendin tonë gjenden parashikime të shpërndara, të posaçme, në ligje të ndryshme, për garantimin dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Më konkretisht këto parashikime gjenden në:

- **Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon dënime për fyerjen⁷⁷ dhe shpifjen⁷⁸, sidomos kur këto vepra penale kryhen publikisht, ose nëpërmjet medias.**
- **Ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive ne Republikën e Shqipërisë”,** që rregullon funksionimin e radiove, televizioneve dhe portaleve online, si dhe garanton pluralizmin dhe pavarësinë e medias.
- **Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,** i ndryshuar, që garanton dhe mbron të drejtën e qytetarëve për të marrë informacion nga institucionet publike.

Liria e shprehjes mund të ushtrohet lirshëm, por gjithmonë brenda kufijve të respektimit të të drejtave të ligjshme të individëve të tjerë, si dhe të mbrojtjes së interesave publike. Kjo liri themelore nuk është absolute, por ajo mund të kufizohet, përmes marrjes së masave ligjore të nevojshme dhe proporcionale. Kufizimi i lirisë së shprehjes mund të kryhet për arsye që lidhen me; mbrojtjen e rendit publik dhe sigurisë kombëtare, mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të të tjerëve, parandalimin dhe nxitjen e urrejtjes, dhunës ose diskriminimit, si dhe me mbrojtjen e sekretit shtetëror ose informacioneve konfidenciale.

Realiteti i krijuar tashmë në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore dhe përdorimit të internetit, kërkon një qasje të kujdesshme në kushtet kur kufizimi i aksesit në internet mund të vlerësohet edhe si masë kuzuese ndaj këtyre të drejtave dhe lirive themelore. Në

drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.

⁷⁵ *Lingens kundër Austrisë*, application nr. 9815/82, datë 8 korrik 1986, § 41.

⁷⁶ **Në nenin 19**, të këtij instrumenti ndërkombëtar parashikohet se:

“1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje.

2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.

3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve, të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme:

(a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve;

(b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik”.

⁷⁷ Shih nenin 119, të Kodit Penal.

⁷⁸ Shih nenin 120, të Kodit Penal.

çdo rast, kufizimet ligjore për rregullimin e përmbajtjes përkatëse në internet, duhen përcaktuar në përputhje me nenin 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 10, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke respektuar kriteret e vendosura në to.

Si i tillë, çdo kufizim i kësaj lirie themelore duhet të jetë i bazuar në ligj, i nevojshëm dhe proporcional në përputhje me kushtet dhe standardet e një shoqëri demokratike.⁷⁹

3. Garantimi dhe kufizimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike

Liria ekonomike është një prej koncepteve më të reja që ka zënë vend në kushtetutat moderne. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon bazat e sistemit ekonomik, duke njohur dhe garantuar mbrojtje të njëjtë ligjore, si për pronën private, ashtu dhe atë publike, si dhe duke garantuar lirinë e veprimtarisë ekonomike private.⁸⁰

Kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Nisur dhe nga struktura e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjvënësi ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe së dyti, si pjesë e katalogut të lirive dhe të drejtave të shtetasve.⁸¹

Një individ i lirë ekonomikisht është ai që mund të kontrollojë plotësisht punën, ose pronën e tij. Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e ka trajtuar këtë liri kushtetuese, si në aspektin e detyrimit të shtetit për të mos ndërhyrë në jetën dhe sferën e veprimtarisë së subjekteve private, ashtu dhe në këndvështrimin e hapësirës që i lihet individit për të vepruar me qëllim zhvillimin e lirë të personalitetit të tij aty, ku ai e sheh veten më produktiv. Në këtë kontekst, individët kanë autonomi dhe janë të lirë të përcaktojnë vetë kushtet dhe llojin e kontratave civile, që do të lidhin me njëri-tjetrin, me kusht që këto veprime juridike të mos vijnë në kundërshtim me normat urdhëruese të ligjit.⁸²

⁷⁹ Pra, ky kufizim duhet të ndodhë në përputhje me nenin 17, të **Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:**

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara nga kjo Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj, për një qëllim legjitim në një shoqëri demokratike.

2. Kufizimi nuk mund të prekë thelbin e lirisë dhe duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.”

⁸⁰ Në nenin 11, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

“Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

2. Prona private dhe publike mbrohen njëlligj me ligj.

3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike”.

⁸¹ Shih vendimin nr. 10, datë 19.03.2008, ku Gjykata Kushtetuese konstatoi se përmbajtja e dispozitës së nenit 2, pika e 3, e ligjit nr. 9744, datë 28.05.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8701, datë 01.12.2000 “Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar, është në përputhje me nenet 11/3, 17/2, 41/4 dhe 42/1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁸² Shih vendimin nr. 40, datë 11.03.2002, ku Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin si antikushtetues të nenit 3, të ligjit nr. 8472, datë 08.04.1999 “Për kthimin në shoqëritë huamarrësve të vlerave financiare të përfituara nga personat fizikë e juridikë, nëpërmjet shitjes së pasurive, apo transaksioneve të pronësisë”.

Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë e qarkullimit të punës, të kapitalit dhe të mallrave pa asnjë kufizim. Në këtë kuptim, individit ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti. Gjykata Kushtetuese ka nënvizuar vazhdimisht se liria e veprimtarisë ekonomike është një liri negative për atë kohë sa lidhet me vullnetin e individit për të zgjedhur fushën e ushtrimit të kësaj veprimtarie duke hyrë lirisht në marrëdhënie ekonomike me subjekte të tjera. Përveç kësaj, liria e veprimtarisë ekonomike ka dhe aspektin e saj pozitiv i cili nënkupton detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë, apo fusha të caktuara. Në këtë rast, shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike nga njëra anë dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbart me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike.⁸³

Pavarësisht këtij kriteri kufizimi, duke qenë se Gjykata Kushtetuese e shqyrton cenimin, ose jo të kësaj lirie të lidhur ngushtë me sferën e individit, është e detyruar t'i drejtohet edhe përmbajtjes së nenit 17, paragrafi 1 të Kushtetutës, e cila shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejtë qëllimit që synohet të arrihet.⁸⁴

Veprimtaria rregullatore e ligjvënësit nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, duhet të qëllimjohë disiplinimin e ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë, apo fusha të caktuara. Pra, shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë dhe të mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër.⁸⁵

Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar se pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut, apo interesave të një shteti social. Këto masa të ligjvënësit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, (si për shembull, vendosja e tatimeve dhe taksave, e cila në vetvete konsiderohet si një lloj kufizimi). Në përgjithësi garantimi i mundësisë së individit për të zgjedhur lirisht fushën e veprimtarisë së tij (iniciativa ekonomike) dhe për të realizuar idetë e tij mbi aktivitetin ekonomik që ai ka zgjedhur është konsideruar i mjaftueshëm. Ajo që ka rëndësi është që, thelbi i aktivitetit të individit të mos cenohet deri në atë masë, sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij.⁸⁶

⁸³ Shih vendimin nr. 10, datë 19.03.2008, të Gjykatës Kushtetuese, pika 1, paragrafi 6.

⁸⁴ Shih vendimin nr. 17, datë 27.03.2012, të Gjykatës Kushtetuese.

⁸⁵ Shih vendimin nr. 17, datë 25.07.2008, ku Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës së Shoqatës së ndërtuesve të Shqipërisë, me objekt —Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 15.08.2007 “Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit”.

⁸⁶ Shih vendimin nr. 28, datë 27.05.2010 (pika 16), ku Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës së Shoqatës së Distributorëve të Shqipërisë me objekt —Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 13.05.2009 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre në pjesën integrale nga lista e çmimeve të barnave që rimbursohen”.

4. Ndërveprimi i lirisë së shprehjes me lirinë e veprimtarisë ekonomike, si dhe me të drejta e liri të tjera të njeriut.

Përdorimi masiv i rrjeteve sociale nga një gamë e gjerë përdoruesish ka sjellë një ndërveprim të natyrshëm ndërmjet lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe lirisë së shprehjes, pa përjashtuar këtu edhe të drejta dhe liri të tjera të njeriut.

Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është vënë në dukje në disa raste se aktiviteti shprehës i gjeneruar nga përdoruesit në internet ofron një platformë të pashembullt për ushtrimin e lirisë së shprehjes (*Delfi AS kundër Estonisë [GC]*, application nr. 64569/09, datë 16.6.2015 § 110; *Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë*, application nr. 48226/10, datë 01.12.2015 § 52), duke vendosur se, duke pasur parasysh aksesueshmërinë dhe kapacitetin e tij për të ruajtur dhe komunikuar sasi të mëdha informacioni, interneti luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit të publikut në lajme dhe lehtësimin e përhapjes së informacionit në përgjithësi (*Delfi AS kundër Estonisë [GC]* application nr. 64569/09, datë 16.6.2015 § 133; *Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1 dhe nr. 2)*, applications nr. 3002/03 and 23676/03, datë 10.03.2009 § 27). Prandaj, kjo gjykatë konsideron se bllokimi i aksesit në internet mund të jetë në konflikt të drejtpërdrejtë me formulimin aktual të paragrafit 1, të nenit 10, të KEDNJ-së, sipas të cilit të drejtat e përcaktuara në atë Nen, sigurohen “pavarësisht kufijve” (*Ahmet Yıldırım kundër Turqisë*, application nr. 3111/10, datë 18.12.2012 § 67).

Ndërkohë, lidhur me fushëveprimin material të nenit 10, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se kjo dispozitë duhet të zbatohet për komunikimin në internet, pavarësisht nga lloji i mesazhit që përçohet dhe madje edhe kur qëllimi është i natyrës fitimprurëse (*Ashby Donald dhe të tjerë kundër Francës*, application nr. 36769/08, datë 10 janar 2013 § 34)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka konsideruar në veçanti se, sferat e mëposhtme mbulohen nga ushtrimi i të drejtës së lirisë së shprehjes:

- mirëmbajtja e arkivave të internetit për aq sa ato përfaqësojnë një aspekt kritik të rolit që luajnë faqet e internetit (*Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1 dhe nr. 2)*, applications nr. 3002/03 and 23676/03, datë 10.03.2009 § 27; *M.L. dhe W.W. kundër Gjermanisë*, application nr. 60798/10 dhe 65599/10, datë 28.6.2018; *Węgrzynowski dhe Smolczewski kundër Polonisë*, application nr. [33846/07](#), datë 16.10.2013);
- publikimi i fotografive në një faqe interneti të specializuar në modë dhe që ofron fotografi dhe video të sfilatave të modës falas ose me pagesë (*Ashby Donald dhe të tjerë kundër Francës*, application nr. 36769/08, datë 10 janar § 34);
- fakti që një parti politike vë në dispozicion një aplikacion celular që u lejon votuesve të ndajnë fotografi anonime të fletëve të tyre të votimit të pavlefshme dhe komente mbi arsyet e tyre për të votuar në këtë mënyrë (*Magyar Kétfarkú Kutya Párt kundër Hungarisë [GC]*, application nr. [201/17](#), datë 20.01.2020 § 91);
- përdorimi i disa faqeve që lejojnë ndarjen e informacionit, në veçanti YouTube, një faqe interneti për pritjen e videove në të cilën përdoruesit mund të ngarkojnë, shikojnë dhe ndajnë video (*Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë*, application nr. 48226/10, datë 01.12.2015 § 52), dhe Google Sites, një shërbim i Google i projektuar për të lehtësuar krijimin dhe ndarjen e faqeve të internetit brenda një grupi (*Ahmet Yıldırım kundër Turqisë*, application nr. 3111/10, datë 18.12.2012 § 49);
- përdorimi i butonit “Pëlqej” në rrjetet sociale (*Melike kundër Turqisë*, application nr. 35786/19, datë 15.06.2021 § 44).

Ndërsa pranon përfitimet e internetit, kjo gjykatë ka pranuar gjithashtu se këto përfitime shoqërohen nga një numër rreziqesh, në atë që fjalimet qartësisht të paligjshme, duke përfshirë vërejtjet shpifëse, gjuhën e urrejtjes dhe fjalimet që nxisin dhunën, mund të përhapen si kurrë më parë, në të gjithë botën, brenda pak sekondash, dhe nganjëherë mbeten vazhdimisht të disponueshme në internet (*Delfi AS kundër Estonisë [GC]*, application nr. 64569/09, datë 16.6.2015 § 110; *Annen kundër Gjermanisë*, application nr. 3690/10 Vendim 26.11.2015 § 67).

Më konkretisht, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut pranon se interneti është një mjet informacioni dhe komunikimi veçanërisht i ndryshëm nga media e shtypur, veçanërisht në lidhje me aftësinë për të ruajtur dhe transmetuar informacion. Ajo ka pranuar se rrjeti elektronik, që u shërben miliarda përdoruesve në të gjithë botën, nuk është dhe potencialisht nuk do t'i nënshtrohet kurrë të njëjtave rregullore dhe kontrolli, dhe se politikat që rregullojnë riprodhimin e materialit nga media e shtypur dhe interneti mund të ndryshojnë. Rregullat që rregullojnë këtë të fundit padyshim duhet të përshtaten sipas karakteristikave specifike të teknologjisë në mënyrë që të sigurohet mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore (*Bordi Editorial i Pravoye Delo dhe Shtekel kundër Ukrainës*, application nr. 33014/05, datë 05.05 2011 § 63).

Po kështu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vënë re se, megjithëse interneti dhe mediat sociale mbeten mjete të fuqishme komunikimi, zgjedhjet e natyrshme në përdorimin e internetit dhe mediave sociale nënkuptojnë që, informacioni që del prej tyre nuk ka të njëjtën sinkronitet, ose ndikim si informacioni i transmetuar (*Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC]*, application nr. 24839/94, 19 shkurt 1998 § 119), dhe se një intervistë telefonike e transmetuar në një program të disponueshëm në një faqe interneti kishte një ndikim më pak të drejtpërdrejtë tek shikuesit sesa një program televiziv (*Schweizerische Radio- und Fernsehgesellschaft SRG kundër Zvicrës*, application no. [34124/06](#), datë 21.09.2012 § 64).

Aspektet specifike të ushtrimit të lirisë së shprehjes në kontekstin e internetit e kanë shtyrë Gjykatën Evropiane e të Drejtave të Njeriut, të shqyrtojë ekuilibrin e drejtë midis lirisë së shprehjes dhe të drejtave dhe kërkesave të tjera. Në këtë drejtim, ajo konsideron se rreziku i dëmit që paraqet përmbajtja dhe komunikimet në internet për ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht të drejtën për respektimin e jetës private, është sigurisht më i lartë se ai që paraqet shtypi (*Delfi AS kundër Estonisë [GC]*, application nr. 64569/09, datë 16.6.2015 § 133; *Bordi Editorial i Pravoye Delo dhe Shtekel kundër Ukrainës*, application nr. 33014/05, datë 05.05 2011 § 63; *Węgrzynowski dhe Smolczewski kundër Polonisë*, application nr. [33846/07](#), datë 16.10.2013 § 98). Kështu, ndërsa njihen përfitimet e rëndësishme që mund të nxirren nga interneti në ushtrimin e lirisë së shprehjes, përgjegjësia për shpifje ose lloje të tjera të fjalës së paligjshme, në parim, duhet të mbahet dhe të përbëjë një mjet efektiv për shkeljet e të drejtave të personalitetit (*Delfi AS kundër Estonisë [GC]* application nr. 64569/09, datë 16.6.2015 § 110).

Megjithatë, mund të merren në konsideratë edhe faktorë të tjerë që zbusin efektet e mesazheve nga përdoruesit e internetit mbi interesat e mbrojtura nga neni 10, paragrafi 2 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Për shembull, dërgimi i një mesazhi në një mjedis të rezervuar për profesionistët në një fushë të caktuar mund të jetë një faktor lehtësues nëse shpërndarja e mesazhit është shumë e kufizuar për të shkaktuar dëme të konsiderueshme, ndryshe nga një mesazh që do të ishte i arritshëm për të gjithë

përdoruesit e internetit (*Kozan kundër Turqisë*, application nr. 16695/19, datë 01.03.2022 § 51).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka vendosur në disa raste mbi përputhshmërinë me nenin 10, të Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të masave të marra nga autoritetet kombëtare që bllokojnë aksesin në faqe të caktuara interneti. Lidhur me bllokimin e faqes së pritjes së videove në YouTube, kjo gjykatë ka vënë në dukje se kërkuesit, megjithëse ishin përdorues të thjeshtë që nuk ishin të shënjestruar drejtpërdrejtë nga vendimi për të bllokuar aksesin në YouTube, mund të pretendonin në mënyrë legjitime se masa e kontestuar kishte ndikuar në të drejtën e tyre për të marrë dhe shpërndarë informacion ose ide, në atë që ata ishin përdorues aktivë të YouTube dhe se kjo platformë ishte unike, për shkak të karakteristikave të saj, aksesueshmërisë së saj dhe mbi të gjitha ndikimit të saj të mundshëm, dhe se nuk kishte alternativa në dispozicion për kërkuesit (*Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë*, application nr. 48226/10, datë 01.12.2015 §§ 52, 53, 55; shih gjithashtu, *Ahmet Yıldırım kundër Turqisë*, application nr. 3111/10, datë 18.12.2012 §§ 49 dhe 55, në lidhje me faktin se ishte e pamundur për një individ të hynte në faqen e tij të internetit, të vendosur në një shërbim pritjeje të Google Sites, si dhe *Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë*, application § 62, që ka të bëjë me lirinë për të marrë dhe përhapur informacion dhe ide).

Lidhur me faktin nëse masa e bllokimit ishte e justifikuar, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që, megjithëse kufizime të tilla paraprake nuk ishin të papajtueshme me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në parim, ato megjithatë duhej të formonin pjesë të një kuadri ligjor veçanërisht të rreptë që siguronte si kontroll të rreptë mbi fushëveprimin e ndalimit, ashtu edhe shqyrtim efektiv gjyqësor për të parandaluar çdo abuzim. Rishikimi gjyqësor i një mase të tillë, bazuar në një peshim të interesave konkurruese në lojë dhe të hartuar për të vendosur një ekuilibër midis tyre, është i pakonceptueshëm pa një kuadër që përcakton rregulla të sakta dhe specifike në lidhje me zbatimin e kufizimeve parandaluese mbi lirinë e shprehjes (*Ahmet Yıldırım kundër Turqisë*, application nr. 3111/10, datë 18.12.2012 § 64; shih gjithashtu *OOO Flavus dhe të tjerë kundër Ruisë*, application nr. 12468/15, datë 23.06.2020 §§ 40-43).

Kjo gjykatë ka theksuar, në veçanti, nevojën për të peshuar interesat e ndryshme në lojë, në veçanti duke vlerësuar nevojën për të bllokuar të gjithë aksesin në faqe të caktuara (*Ahmet Yıldırım kundër Turqisë*, application nr. 3111/10, datë 18.12.2012 § 66) dhe ka vënë në dukje se autoritetet duhet të kishin marrë në konsideratë, ndër aspekte të tjera, faktin se një masë e tillë, duke i bërë sasi të mëdha informacioni të paarritshme, do të kufizonte ndjeshëm të drejtat e përdoruesve të internetit dhe do të kishte një efekt të rëndësishëm anësor (*ibid.*; *Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë*, application nr. 48226/10, datë 01.12.2015 § 64).

Në rastin *Vladimir Kharitonov kundër Ruisë*, application nr. 10795/14, datë 23.6.2020 §§ 45 dhe 47, në lidhje me bllokimin e një faqeje interneti si pasojë automatike e një urdhri bllokimi kundër një faqeje tjetër me të njëjtën adresë IP, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vuri në dukje se kjo masë kishte pasur një efekt të konsiderueshëm anësor, duke bërë sasi të mëdha informacioni të paarritshme, dhe kështu kishte kufizuar ndjeshëm të drejtat e përdoruesve të internetit. Gjykata konsideroi se kuadri ligjor mbi të cilin autoritetet kompetente bazuan vendimin e tyre nuk kishte qenë mjaftueshëm i parashikueshëm për qëllimet e nenit 10, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konstatuar në disa raste se një urdhër bllokimi i plotë kundër një faqeje interneti është një masë ekstreme. Në rastin, *OOO Flavus dhe të tjerë kundër Rusisë*, (application nr. 12468/15, datë 23.06.2020, §§ 34), në lidhje me bllokimin e plotë të pajustificuar të mediave online të opozitës, Gjykata konsideroi se kjo masë, e cila qëllimisht injoroi dallimin midis informacionit të ligjshëm dhe të paligjshëm, ishte arbitrare dhe qartësisht e paarsyeshme.

5. Baza rregullatore normuese e përdorimit të platformave sociale në vendet evropiane dhe në Shqipëri

Në kushtet kur interneti është bërë një medium i rëndësishëm komunikimi dhe një katalizator për lirinë e shprehjes dhe të informacionit, kusht thelbësor për përdorimin e platformave online, apo rrjeteve sociale është ekzistenca e një legjislacioni rregullator të plotë dhe gjithëpërfshirës, në këtë fushë.

Bashkimi Evropian ka krijuar një kuadër ligjor gjithëpërfshirës dhe të avancuar për të rregulluar platformat online. Baza kryesore normuese në këtë fushë përfaqësohet nga “Akti i Shërbimeve Dixhitale”, si komponent kryesor legjislativ i strategjisë dixhitale të Bashkimit Evropian që synon krijimin e një hapësire dixhitale më të sigurt.⁸⁷ Qëllimi i tij është krijimi i një hapësire dixhitale më të sigurt duke futur rregulla gjithëpërfshirëse për platformat online, duke garantuar sigurinë e përdoruesit dhe duke përcaktuar llogaridhënie. Ky akt parashikon se platformat online duhet të zbulojnë politikën, algoritmet dhe praktikën e reklamimit të tyre e të përmbajtjes. Në të përcaktohen gjithashtu, masa më të forta për të parandaluar dhe hequr përmbajtjet dhe shërbimet e paligjshme në internet, si dhe për krijimin e mekanizmave të mbikëqyrjes rregullatore, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel të Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër ligjor përfshihet edhe “Akti i Tregjeve Dixhitale”,⁸⁸ General Data Protection Regulation⁸⁹ dhe Direktiva e Tregtisë Elektronike.⁹⁰ Ky sistem normues synon mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njohura me ligj në hapësirën e vendeve të Bashkimit Evropian, përfshirë këtu edhe lirinë e shprehjes.

Kushti i parë thelbësor në përdorimin e rrjeteve sociale është sigurimi i aksesit të përdorimit të tyre. Si një mundësi që përdoruesi ka për të hyrë dhe shfrytëzuar shërbimet e rrjeteve sociale, aksesit përfshin hyrjen në platformë, krijimin e një profili, shfletimin e përmbajtjeve, postimin e materialeve, komentimin, ndarjen, etj. Aksesit mund të jetë **i hapur** (për këdo që ka internet dhe pajisje) ose **i kufizuar** (p.sh. për përdorues që plotësojnë moshën minimale, ose për vendet ku ka censurë).

Këshilli i Evropës ka konsideruar se parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatohen edhe për internetin. Kjo presupozon se nuk duhet të ketë kontroll, ose kufizim të aksesit në informacion në internet, megjithëse duhet të merren masa për të mbrojtur

⁸⁷ Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market for Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 277/1. Për një vështrim të përgjithshëm shiko Commission, Digital Services Act aksesuar me 12 qershor 2024.

⁸⁸ Regulation (EU) 2022/1925 of the European Parliament and of the Council of 14 September 2022 on contestable and fair markets in the digital sector and amending Directives (EU) 2019/1937 and (EU) 2020/1828 (Digital Markets Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 265/1.

⁸⁹ Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation) (Text with EEA relevance) [2016] OJ L 119/1

⁹⁰ Directive 2000/31/EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market ('Directive on electronic commerce') [2000] OJ L 178/1

fëmijët dhe grupet e tjera vulnerabël. Komiteti i Ministrave mbron gjithashtu parimin e vetërregullimit dhe anonimitetin e përdoruesve.

Duke iu referuar kuptimit të parimit të vetërregullimit dhe anonimitetit të përdoruesve në rrjete sociale, **vetërregullim** do të thotë që platforma sociale të përcaktojë dhe zbatojë vetë rregullat e tyre për sjelljet dhe përmbajtjet në mënyrë që të krijojnë një ambient të sigurt dhe të respektueshëm. Në këto rregulla sjelljeje përfshihen; -Politika për ndalimin e përmbajtjeve të dëmshme (të urrejtjes, dezinformimit, ngacmimeve), -Kontrolli i përmbajtjeve nga moderator, -Mbrojtja e privatësisë dhe e të dhënave të përdoruesve. Në thelb, vetërregullimi është një alternativë ndaj rregullimit shtetëror, apo ligjor, dhe shpesh përdoret për të balancuar lirinë e shprehjes, me sigurinë dhe etikën online.

Anonimiteti i përdoruesve, nënkupton mundësinë e përdoruesit të rrjetit social, pa zbuluar identitetin e tij të vërtetë, duke përdorur pseudonime, avatarë, ose të fshehë detajet personale. Anonimiteti mundëson shprehje më të lirë, veçanërisht në temat delikate, por gjithashtu mund të krijojë probleme si abuzime, ngacmime apo përhapje lajmesh të rreme.

Nga një lidhje logjike dhe praktike e koncepteve që i referohen përdorimit të rrjeteve sociale, rezulton se **aksesi mund të jetë i kushtëzuar nga respektimi i rregullave të vetërregullimit**, dhe se anonimiteti i përdoruesve nuk është absolut, por i menaxhuar për të ruajtur sigurinë dhe komunitetin. **Aksesi** duhet të jetë i drejtë dhe i barabartë, por platforma mund të vendosë rregulla për të kufizuar aksesin e përdoruesve që shkelin rregullat e vetërregullimit. **Vetërregullimi** përcakton se si platforma menaxhon sjelljen e përdoruesve anonimë, sepse anonimiteti mund të nxisë sjellje të papërshtatshme. **Anonimiteti** mbrohet nga platforma deri në një masë, por jo nëse përdoruesi e përdor atë për qëllime keqdashëse dhe në këto raste, platforma mund të ndërmarrë masa, si bllokim, apo kërkesë për verifikim të identitetit.

Në vendin tonë është vërejtuar vitet e fundit, një rritje e ndjeshme e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Ky zhvillim ka nxjerrë nevojën e miratimit të një legjislacioni koherent për të garantuar sigurinë, besueshmërinë dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara. Korniza ligjore në fuqi në vendin tonë, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit përfshin një sërë ligjesh, që synojnë rregullimin dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe bizneseve në këtë sektor.⁹¹

Megjithatë, krahasimisht me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian, kuadri ynë ligjor në këtë fushë mbetet relativisht i mangët. Kuadri ynë ligjor nuk përmban dispozita të detajuara që adresojnë përgjegjësinë e ndërmjetësimit, moderimin e përmbajtjes, apo kërkesat e transparencës për platformat online. Mungesa e kërkesave të standardizuara për moderimin e përmbajtjes do të thotë se nuk ka rregullim ligjor për identifikimin, rishikimin dhe heqjen e përmbajtjeve të paligjshme, ose të dëmshme.

Në një vështrim krahasues, "Akti i Shërbimeve Dixhitale" vendos detyrime të qarta për platformat në lidhje me moderimin e përmbajtjes, duke përfshirë raportet e transparencës dhe masat mbrojtëse procedurale për përdoruesit. Legjislacioni ynë në fuqi, nuk ka kërkesa të detajuara për mënyrën sesi platformat duhet të trajtojnë përmbajtjen e paligjshme, ose të dëmshme dhe duke ofruar më pak qartësi për përgjegjësinë e ndërmjetësve.

⁹¹ Përmendim këtu; ligjin nr. 9157 datë 4.12.2003 "Për Përgjimin e Telekomunikimeve", të ndryshuar, Ligjin nr. 9880 datë 25.2.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik", të ndryshuar, Ligjin nr. 9918/2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjin nr.10 128, datë 11.5.2009 "Për Tregtinë Elektronike", të ndryshuar, Ligjin nr. 10 273, datë 29.4.2010 "Për Dokumentin Elektronik", të ndryshuar, Ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjin nr. 107/2015 datë 1.10.2015 "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara", Ligjin nr. 25/2024 "Për Sigurinë Kibernetike", Ligjin nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike", Ligjin nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

“Akti i Shërbimeve Dixhitale” dhe “Akti i Tregjeve Dixhitale”, theksojnë kriterin e transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke kërkuar që platformat të zbulojnë informacion në lidhje me algoritmet e tyre, praktikat e reklamimit dhe përpjekjet për të luftuar përmbajtjen e paligjshme. Legjislacioni ynë ka mangësi në këtë drejtim, fakt që derivon në mungesë mbikëqyrjeje dhe llogaridhënieje për platformat online, të cilat operojnë në vend. Bashkimi Evropian ka krijuar mekanizma të fuqishëm të monitorimit dhe zbatimit të legjislacionit të kësaj fushe, përfshirë këtu dënimin administrativ me gjobë dhe aftësinë për të kufizuar operacionet e platformave që nuk janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit rregullator.⁹² Ndërkohë, vendi ynë e ka të mangët pjesën e mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të legjislacionit të kësaj fushe, si dhe pjesën e organeve rregullatore me burime, ose autoritet të mjaftueshëm për të monitoruar dhe sanksionuar në mënyrë efektive, në rast shkeljeje, platformat online.

Kjo situatë, identifikon mungesën e rregullimeve të nevojshme ligjore për moderimin dhe përgjegjësinë e përmbajtjes, transparencën dhe llogaridhënien, si dhe zbatimin dhe mbikqyrjen rregullatore të rrjeteve sociale, në vendin tonë.

Në këto rrethana është thelbësore që të miratohet një ligj specifik për rregullimin e platformave të mediave sociale. Ky ligj duhet të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve, përgjegjësitë e platformave për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat personale të përdoruesve, si dhe mekanizma efektivë për monitorimin dhe zbatimin e rregullave, për të garantuar që platformat të veprojnë në përputhje me standardet e larta të sigurisë dhe etikës.

Mungesa e një legjislacioni të qartë dhe të plotë rregullator për ushtrimin e veprimtarisë normale të platformave on line/rrjeteve sociale, apo edhe e mekanizmave monitorues dhe kontrollues për këtë qëllim, përbën një premisë të dukshme për shkeljen, apo cenimin e parimit të sigurisë juridike⁹³ në këtë fushë, për cenimin e pritshmërive të ligjshme të operatorëve që ofrojnë aksesin në këto platforma, si dhe të përdoruesve të këtyre platformave.

Si standarde formale kryesore të parimit të sigurisë juridike konsiderohen saktësia, qartësia, dhe qëndrueshmëria në tërësi e të gjithë rendit juridik të një shteti të caktuar. Nga ana tjetër, si standarde kryesore në kuptimin material të parimit të sigurisë juridike konsiderohen moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Me një fjalë, jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm, i parashikueshëm dhe jo kontradiktor. Në këtë mënyrë, vlerësohet se krijohet edhe besimi i qytetarëve në qëndrueshmërinë e këtij rendi, si dhe bindja e tyre në nevojën e respektimit dhe zbatimit të tij në jetën e përditshme. Në të

⁹² Sjellim në vëmendje hapjen e procedurave zyrtare në 19 shkurt 2024, Komisioni ka hapur procedurat zyrtare për të vlerësuar nëse Tik Tok mund të ishte shkelur Aktin e Shërbimeve Dixhitale. Përveç transparencës reklamuese, hapja e procedimit do të vlerësonte gjithashtu efektet negative që mund të rrjedhin nga dizajni i algoritmit të Tik Tok (sisteme të tilla si “efektet e vrimës së lepurit” dhe varësia e sjelljes, sigurimi i moshës, detyrimi i platformës për të siguruar një nivel të lartë privatësie, sigurie dhe vecanërisht siguri për të miturit, si dhe akses të dhënash për studiuesit).

Në datën 15 maj 2025, Komisioni ka publikuar gjetjet paraprake

(https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_25_1223), sipas të cilave Tik Tok nuk përmbush detyrimin e Aktit të Shërbimeve Dixhitale për të publikuar advertisement repository (depon dixhitale). Nëse pikëpamjet paraprake të Komisionit do të konfirmohen përfundimisht, Komisioni mund të marrë vendim për mospërputhje, i cili mund të shoqërohet me një gjobë deri në 6% të xhiros totale vjetore në mbarë botën të ofruesit, si dhe një periudhë të zgjeruar mbikëqyrjeje, për të siguruar respektimin e masave që ofruesi duhet të ndërmarrë për të korrigjuar shkeljet. Komisioni mund të vendosë edhe gjoba të tjera periodike, me qëllim që të detyrojë një platformë të pajtohet me legjislacionin e BE-së. Tik Tok ka mundësinë të ushtrojë të drejtat e tij të mbrojtjes duke ekzaminuar dokumentet në dosjen hetimore të Komisionit dhe duke iu përgjigjur me shkrim gjetjeve paraprake të Komisionit.

⁹³ Parimi i sigurisë juridike është gjithashtu, një element shumë i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Baza kushtetuese për evidentimin e këtij parimi të rëndësishëm bëhet duke ju referuar angazhimit për respektimin e shtetit të së drejtës që përmendet shprehimisht në Preambulën e Kushtetutës.

njëjtën kohë, mbi këtë bazë, qytetarët përcaktojnë edhe hapësirën e lirisë, apo mënyrën e sjelljes së tyre në shtet dhe shoqëri.⁹⁴

Ekzistenca e një norme juridike në sistemin ligjor nuk është e mjaftueshme për të konsideruar të plotësuar kërkesën për siguri juridike, kjo për faktin se norma duhet të jetë edhe e qartë. Paqartësia nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike.⁹⁵ Siguria juridike kërkon domodoshmërisht që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshëm. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet, të cilëve u drejtohet ligji në tërësi, ose dispozita të veçanta të tij.

Një aspekt i rëndësishëm i çdo regjimi të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore është miratimi dhe hyrja në fuqi e një legjislacioni specifik për njohjen dhe mbrojtjen e tyre, si dhe përcaktimi i qartë i organeve apo strukturave, të cilat kanë detyrimin e mbikqyrjes së zbatimit të këtij legjislacioni.

6. Proporcionaliteti i ndërhyrjes kufizuese

Parimi kushtetues i proporcionalitetit që buron nga koncepti i kufizimit të ligjshëm të të drejtave dhe lirive në kuptim të nenit 17, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, është një parim që rrjedh nga vetë thelbi i të drejtave themelore të cilat, si shprehje e pretendimit të përgjithshëm të qytetarit për të qenë i lirë nga ndërhyrjet e pushtetit shtetëror, të drejtat themelore mund të kufizohen deri në atë pikë sa të jetë e lejueshme për mbrojtjen e interesave publike. Në këtë kuadër, ky parim shërben si masë kontrolli kushtetues edhe për veprimtarinë e politikën legjislative të Kuvendit.⁹⁶

Kufizimi i të drejtës duhet të respektojë krahas kushtit të ruajtjes së esencës së të drejtës edhe kushtin tjetër që kufizimi i vendosur nga ligjvënësi të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Përveç kësaj, kushti i proporcionalitetit të ndërhyrjes me gjendjen që e ka diktuar ndërhyrjen, imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Për më tepër, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë gjithashtu me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë.⁹⁷

Kushti i përpjesëtimimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit.

Një e drejtë apo interes, pavarësisht rëndësisë publike apo vlerës që bart, nuk mund të peshojë në mënyrë disproporcionale me një të drejtë, apo interes tjetër të mbrojtur nga Kushtetuta dhe ligji. Marzhi i këtij vlerësimi dhe, për rrjedhojë, edhe raporti që krijohet ndërmjet interesit të mbrojtur dhe atij të cenuar, ndryshon në çdo rast konkret. Ai varet nga

⁹⁴ Degenhart C., Staatsrecht I, Botuar nga CF Muller Verlag, Gjermani, 1998.

⁹⁵ Shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005, nr.14, datë 22.05.2006, nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

⁹⁶ Shih vendimet nr. 16, datë 11.11.2004 dhe nr. 38, datë 25.07.2013, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

⁹⁷ Shih vendimet nr. 16, datë 25.07.2008 dhe nr. 9, datë 23.03.2010, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

një sërë rrethanash dhe kushtesh që ndryshojnë nga një vend në tjetrin, nga një periudhë e caktuar kohore në tjetrën, në varësi të të drejtave që vendosen në balancë dhe pasojave që do të kishte përparësia e secilës prej tyre.⁹⁸

Konkretizimi i parimit të proporcionalitetit e detyron ligjvënësin që në çdo rast të vërë në balancë përfitimet publike në raport me cenimin e të drejtave të individëve duke pasur si kufizim logjik dhe juridik të përfitimeve publike, thelbin e të drejtës së individëve. Po ashtu, ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementeve të domosdoshëm kërkon që një masë ose mjet duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjesëtim të arsyeshëm.⁹⁹

Jurisprudenca kushtetuese përcakton se, një kufizim do të konsiderohet në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit nëse: (i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin- ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.¹⁰⁰

Nëse ndërhyrja është e nevojshme, e përshtatshme dhe e arsyeshme, atëherë testi i proporcionalitetit mund të konsiderohet i përmbushur.

Duke vendosur një raport të drejtë dhe të nevojshëm midis proporcionalitetit të ndërhyrjes dhe ndërhyrjes së mundshme kufizuese në aksesin në rrjetet sociale, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, do të duhet që:

- Ndërhyrja kufizuese **ka një qëllim legjitim (kuptuar këtu për shembull mbrojtjen e fëmijëve, sigurinë kombëtare, luftën kundër dezinformimit, ose parandalimin e krimeve kibernetike.**
- Ndërhyrja kufizuese duhet të vijë si pasojë e masave të parashikuara për këtë qëllim, me një **ligj të miratuar nga Kuvendi** i Shqipërisë. Kjo pasi aksesit dhe përdorimi i rrjeteve sociale lidhet me respektimin e një lirie themelore të individit dhe më konkretisht të lirisë së shprehjes dhe të shtypit.
- Ndërhyrja kufizuese është **e domosdoshme në një shoqëri demokratike**, pasi nuk ka alternativë tjetër më të lehtë për të arritur të njëjtin qëllim dhe nuk cenon thelbin e të drejtave të garantuara në Kushtetutë, apo me ligj.
- Ndërhyrja kufizuese duhet të jetë **masa më e butë e mundshme, apo më e përshtatshme dhe jo masa më ekstreme për të arritur qëllimin**. Kjo do të thotë që në vend të ndalimit të aksesit në rrjetin social, mund të kërkohet nga ky rrjet social zbatimi korrekt i normave vetërregulluese, apo rishikimi i tyre i menjëhershëm, për çështje që kanë të bëjnë me p.sh. verifikimin e moshës, ndalimin e disa përmbajtjeve të dëmshme, apo monitorimin e algoritmeve.

⁹⁸ Shih vendimin nr.1, datë 06.02.2013, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

⁹⁹ Shih vendimin nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese, që vendosi pranimin e kërkesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Avokatit të Popullit dhe Grupit Shqiptar të Drejtave të Njeriut duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën të VKM-ve; nr. 43, datë 27.01.2006 —Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekurtimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore; nr. 44, datë 27.01.2006 —Për shmangien e nepotizmit në administratën publike; nr. 48, datë 27.01.2006 —Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave —Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

¹⁰⁰ Shih vendimin nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka arritur në përfundimin se metoda e përzgjedhur nga ligjvënësi, sipas së cilës fatura e energjisë elektrike përbën titull ekzekutiv, ekuilibron interesat e vëna në diskutim, si dhe është diktuar nga domosdoshmëria dhe efektsshmëria për të realizuar shlyerjen e detyrimeve financiare të energjisë elektrike nga konsumatorët, brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Këto kritere janë kumulative dhe nuk mund të kuptohen të ndara nga njëri-tjetri në analizën dhe vlerësimin e një ndërhyrjeje kufizuese për aksesin në rrjetet sociale, qoftë kjo edhe me afat të kufizuar, me pasoja direkte në cenimin e lirisë së shprehjes dhe të shtypit.

Nga praktikat e vendeve të tjera që kanë marrë masa kufizuese për aksesin e përdoruesve në rrjetet sociale rezulton se, masa kufizuese të tilla janë marrë për arsye të pretenduara në mbrojtje të sigurisë kombëtare.¹⁰¹

Në çdo rast, vlerësimi i masës së marrë me natyrë kufizuese për aksesin në platformën sociale, merr rëndësi pasi testimi i masave alternative më të buta si masa të mundshme për të arritur qëllimin mbetet një kërkesë parësore e një ndërhyrjeje proporcionale. Kjo mungesë dhe kalimi direkt në një masë ekstreme sikundër mbyllja, apo kufizimi total i aksesit për të gjithë përdoruesit e një platforme/rrjeti social, qoftë edhe për një periudhë të kufizuar kohore, ngre pikëpyetje të forta për përmbushjen e testit të proporcionalitetit.

Një element tjetër i rëndësishëm në kuadër të nenit 17, të Kushtetutës (lidhur kjo me shumë me proporcionalitetin) lidhet me shkallën e ndërhyrjes së aktit kufizues, jo vetëm sa i takon së drejtës së kufizuar por edhe rrethit të subjekteve, ndaj të cilëve ai prodhon pasojat kufizuese. Në këtë kuadër, është e nevojshme gjetja e një balance të drejtë mes interesit publik justifikues për ndërhyrjen dhe masës përkatëse të marrë, si dhe rrethit të subjekteve që duhet t'i nënshtrohen masës kufizuese, pa cenuar padrejtësisht dhe thelbësisht, të drejta dhe liri të këtyre subjekteve.

Në kuadrin e një mase kufizuese mund të konstatojmë aktualisht, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025, "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line "Tik-Tok".¹⁰² Në pikën 1, të këtij akti normativ, vendoset ndërprerja e aksesit në platformën on-line "TikTok" në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj, me qëllim shmangien e ndikimeve negative dhe të problematikave sociale në tërësi, kryesisht në nxitjen e dhunës, veçanërisht te fëmijët, që sjellin probleme të zhvillimit psiko-social të tyre, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Elementi i parë që vërehet është se ky akt normativ, me natyrë detyruese, vendos kufizimin e përkohshëm të aksesit në një platformë online/rrjet social dhe në këto kushte përbën një masë kufizuese rrjedhimisht të lirisë së medias, lirisë ekonomike, apo edhe të së drejtës për informim, për arsye të analizuara në këtë punim.

Elementi i dytë i vërejtur është se, ky akt normativ jo vetëm ndalon apriori aksesin në një rrjet social, por përkundër qasjes së Bashkimit Evropian për të njëjtën problematikë, vendos pas marrjes së masës së kufizimit, detyrimin ndaj përfaqësuesve të disa institucioneve shtetërore për të komunikuar e negociuar me përfaqësuesit e platformës on-line "Tik Tok", dhe me përfaqësues të platformave të tjera on-line, për të adresuar problematikat në fushën e sigurisë publike dhe sociale në mjedisin digjital.¹⁰³

¹⁰¹ Në shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 2024, Kongresi miratoi ligjin **Protecting Americans from Foreign Adversary Controlled Applications Act (PAFACA)**, i cili kërkonte që Tik Tok të shitej ose të ndalohej nëse nuk ndahej nga kompania kineze ByteDance. Gjykata e Lartë e SHBA-së ka vendosur në janar 2025, se ndalimi i Tik Tok nepermjet këtij ligji ishte një masë proporcionale për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe lirinë e shprehjes nga kërcënimet e mundshme të huaja.

Në maj 2024, qeveria franceze ndaloi Tik Tok në Nju Kaledoni, për të kufizuar komunikimin gjatë trazirave pas një ndryshimi kushtetues. Ky veprim u mbështet në Ligjin e Emergjencës të vitit 1955, por kritikët argumentuan se ai nuk ishte proporcional dhe nuk përputhej me të drejtat e njeriut, duke theksuar se ndalimi i një platforme të tërë ishte një masë ekstreme dhe e pajustificuar.

Në qershor 2020, India ndaloi Tik Tok dhe 58 aplikacione të tjera kineze pas një përplasjeje ushtarake me Kinën. Qeveria indiane e justifikoi këtë masë me shqetësime për sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve. Megjithatë, kritikët theksuan se ndalimi ishte i paqartë dhe mund të kishte ndikime negative në përdoruesit indianë.

¹⁰² Ky vendim i Këshillit të Ministrave, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 07.03.2025.

¹⁰³ Shih pikat 2 dhe 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025, "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line "Tik-Tok".

Sikurse është theksuar më lart, *prima facie* gjasat janë që cenimi i lirisë së shprehjes nëpërmjet mbylljes, apo kufizimit të përdorimit të rrjeteve sociale, cenon drejtpërdrejtë edhe lirinë ekonomike. Çdo cenim, apo kufizim i lirisë së shprehjes në kushtet e ndërveprimit të ndërsjelltë dobiprurës me lirinë e veprimtarisë ekonomike, i konstatuar në kushtet e një ndërhyrjeje aktive nga ana e shtetit, duhet të respektojë kriteret kushtetuese të parashikuara në nenin 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në këto kriteret kushtetuese, hyrja në fuqi e Vendimit të sipërcituar të Këshillit të Ministrave, ngre shqetësim të arsyeshëm për shkelje të neneve 11 dhe 22, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 10 dhe 11, të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Pra, natyrshëm ngrihet pyetja, nëse mjete ligjor i përdorur në këtë rast e justifikon apo jo, arritjen e qëllimit?

Risjellim në vëmendje nenin 17, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili jep garancinë se kufizimi në këtë rast duhet të vijë si pasojë e vullnetit të shprehur të ligjvënësit, nëpërmjet ushtrimit të attributeve nga Kuvendi i Shqipërisë, me miratimin e një ligji specifik dhe jo me mjete të tjera ligjore, të nxjerra nga organe të tjera shtetërore. Asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të marrë dhe zëvendësojë atributet e Kuvendit të Shqipërisë, në aspektin vendimmarrës, për çështje që kanë të bëjnë me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Veç kësaj, kujdes duhet treguar në vlerësimin e masës së marrë me natyrë kufizuese për aksesin në platformën Tik Tok, pasi testimi i masave alternative më të buta si masa të mundshme për të arritur qëllimin mbetet një kërkesë parësore e një ndërhyrjeje proporcionale. Kjo mungesë dhe kalimi direkt në një masë ekstreme sikundër mbyllja, apo kufizimi total i aksesit për të gjithë përdoruesit e një platforme/rrjeti social, qoftë edhe për një periudhë të kufizuar kohore, ngre pikëpyetje të forta për përmbushjen e testit të proporcionalitetit, që në këtë rast ka dështuar.

Një element tjetër i rëndësishëm sa i takon proporcionalitetit të ndërhyrjes, lidhet me shkallën e ndërhyrjes së aktit kufizues, jo vetëm sa i takon lirisë, apo të drejtës së kufizuar por edhe rrethit të subjekteve, ndaj të cilëve ai prodhon pasojat kufizuese. Në këtë kuadër, nevojitet gjetja e një balance të drejtë mes interesit publik justifikues për ndërhyrjen dhe masës përkatëse të marrë nga ana tjetër, si dhe rrethit të subjekteve që duhet t'i nënshtrohen masës kufizuese, pa cenuar padrejtësisht dhe thelbësisht, të drejta dhe liri të këtyre subjekteve. Edhe në këtë këndvështrim, hyrja në fuqi e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025, "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line "Tik-Tok", ngre pikëpyetje të shumta.

7. Konkluzione:

Legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mbron dhe garanton lirinë e shprehjes, si dhe liri dhe të drejta të tjera themelore, por sfidat e zhvillimit teknologjik të informacionit dhe komunikimit kërkojnë vazhdimisht plotësimin dhe përmirësimin e këtij legjislacioni.

Mbyllja e rrjeteve sociale, pa një bazë të qartë ligjore dhe nëpërmjet një ndërhyrjeje kufizuese joproportionale, përbën një cenim të drejtpërdrejtë të lirisë së shprehjes. Ndërhyrja e shtetit në këto kushte mund të cilësohet si **formë censure**, dhe është në kundërshtim me standardet demokratike dhe detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një ndërhyrje të tillë përbën edhe hyrja në fuqi e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025, "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line "Tik-Tok". Ky akt normativ kufizon apriori lirinë e shprehjes, të shtypit dhe të së drejtës për informim, si dhe liri dhe të drejta të tjera që

ndërveprojnë me to në kushtet e përdorimit të rrjeteve sociale nga subjekte të ndryshme. Ky konkluzion bazohet në faktin se për sa kohë norma ligjore jo vetëm nuk siguron baraspeshën e kërkuar mes së drejtës dhe lirisë së kufizuar dhe interesit publik, por përkundrazi e përmbys atë duke vendosur një kufizim ekstrem, kemi mosrespektimin të parimit të proporcionalitetit në ndërhyrjen ligjore të kryer.

Legjislacioni ynë në fuqi që normon kontrollin dhe mbarëvajtjen e rrjeteve sociale është është i mangët, i paqartë dhe i fragmentuar. Ky legjislacion, nuk është përafuar ende mjaftueshëm, me Acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë, ndaj është mjaft e rëndësishme që ky proces përafrimi të ndodhë sa më shpejt. Gjetja e mekanizmave teknikë për bllokimin, apo filtrimin e materialeve "online" është një proces kompleks, i cili detyrimisht duhet të paraprihet nga një bazë e plotë ligjore për kufizimin e lirisë së shprehjes në internet. Këto masa duhet të synojnë karakterin parandalues dhe nuk do të zëvendësojnë masat penalizuese që ekzistojnë në legjislacionin tonë penal, në fuqi.

Kjo qasje është e nevojshme, pasi duhet treguar kujdesi maksimal në rregullimin e raportit të brishtë mes lirisë së shprehjes në internet dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjera të njeriut, për të evituar frymën e politikave bllokuese shtetërore për informacionin e gjendur në internet, me impakt serioz mbi lirinë e shprehjes dhe respektimin thelbësisht të kriterëve të kufizimit të të drejtave themelore të njeriut, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Bllokimi i informacioneve të kundërligjshme, apo të dëmshme në internet, përmes kufizimit të tyre, nuk duhet të kthehet në censurë, apo qëllim në vetvete, por të vlerësohet si një masë fundore rast pas rasti.

platforma/rrjeti Tik Tok, për rrezikun konkret që paraqet përdormi i platformës.

Rëndësi primare merr analiza që duhet ti bëhet të mjetit ligjor të përdorur rast pas rasti, për arritjen e qëllimit. Neni 17, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, jep garancinë se kufizimi në këtë rast duhet të vijë si pasojë e vullnetit të shprehur të ligjvënësit, nëpërmjet ushtrimit të attributeve nga Kuvendi i Shqipërisë, me miratimin e një ligji specifik dhe jo nga attribute të ushtruara nga organe të tjera shtetërore.

Kufizimi i pjesshëm, apo i plotë i përdorimit të këtyre platformave online, nga ana tjetër, pa respektuar rezervën ligjore kushtetuese, në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të lirisë themelore të shprehjes, krijon sfida dinamike në kuadër të respektimit të shtetit të së drejtës dhe të parimeve bazë të një shoqërie demokratike.

Bibliografia:

- 1) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- 2) Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut
- 3) Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
- 4) **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike**
- 5) Rezoluta 428 (1970), e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës
- 6) Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation) (Text with EEA relevance) [2016] OJ L 119/1
- 7) Regulation (EU) 2022/2065 of the European Parliament and of the Council of 19 October 2022 on a Single Market for Digital Services and amending Directive 2000/31/EC (Digital Services Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 277/1

- 8) Regulation (EU) 2022/1925 of the European Parliament and of the Council of 14 September 2022 on contestable and fair markets in the digital sector and amending Directives (EU) 2019/1937 and (EU) 2020/1828 (Digital Markets Act) (Text with EEA relevance) [2022] OJ L 265/1.
- 9) Directive 2000/31/EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market ('Directive on electronic commerce') [2000] OJ L 178/1
- 10) **Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.**
- 11) Ligji nr. 9157 datë 4.12.2003 "Për Përgjimin e Telekomunikimeve", i ndryshuar.
- 12) Ligji nr. 9880 datë 25.2.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik", i ndryshuar.
- 13) Ligji nr. 9918/2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- 14) Ligji nr.10128, datë 11.5.2009 "Për Tregtinë Elektronike", i ndryshuar.
- 15) Ligji nr. 10273, datë 29.4.2010 "Për Dokumentin Elektronik", i ndryshuar.
- 16) **Ligji nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.**
- 17) **Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.**
- 18) Ligjin nr. 107/2015 datë 1.10.2015 "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara".
- 19) Ligji nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike".
- 20) Ligji nr. 25/2024 "Për Sigurinë Kibernetike".
- 21) Ligji nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- 22) Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 06.03.2025, "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line "Tik-Tok".
- 23) Vendime të GJEDNJ-së:**
- 24) *Lingens kundër Austrisë*, application nr. 9815/82, datë 8 korrik 1986.
- 25) *Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC]*, application nr. 24839/94, 19 shkurt 1998.
- 26) *Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 1 dhe nr. 2)*, applications nr. 3002/03 and 23676/03, datë 10.03.2009.
- 27) *Bordi Editorial i Pravoye Delo dhe Shtekel kundër Ukrainës*, application nr. 33014/05, datë 05.05 2011
- 28) *Ahmet Yıldırım kundër Turqisë*, application nr. 3111/10, datë 18.12.2012.
- 29) *Schweizerische Radio- und Fernsehgesellschaft SRG kundër Zvicrës*, application no. [34124/06](#), datë 21.09.2012.
- 30) *Węgrzynowski dhe Smolczewski kundër Polonisë*, application nr. [33846/07](#), datë 16.10.2013
- 31) *Ashby Donald dhe të tjerë kundër Francës*, application nr. 36769/08, datë 10 janar 2013.
- 32) *Delfi AS kundër Estonisë [GC]*, application nr. 64569/09, datë 16.6.2015.
- 33) *Annen kundër Gjermanisë*, application nr. 3690/10 Vendim 26.11.2015.
- 34) *Cengiz dhe të tjerë kundër Turqisë*, application nr. 48226/10, datë 01.12.2015.
- 35) *M.L. dhe W.W. kundër Gjermanisë*, application nr. 60798/10 dhe 65599/10, datë 28.6.2018.

- 36) *Magyar Kétfarkú Kutya Párt kundër Hungarisë [GC]*, application nr. [201/17](#) , datë 20.01.2020.
- 37) *Vladimir Kharitonov kundër Rosisë*, application nr. 10795/14, datë 23.6.2020.
- 38) *OOO Flavus dhe të tjerë kundër Rosisë*, application nr. 12468/15, datë 23.06.2020.
- 39) *Melike kundër Turqisë*, application nr. 35786/19, datë 15.06.2021.
- 40) *Kozan kundër Turqisë*, application nr. 16695/19, datë 01.03.2022.
- 41) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 40 datë 11.03.2002
- 42) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 16 datë 11.11.2004
- 43) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34 datë 20.12.2005
- 44) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 20 datë 11.07.2006
- 45) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.14 datë 22.05.2006
- 46) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 36 datë 15.10.2007
- 47) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 10 datë 19.03.2008
- 48) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 17 datë 25.07.2008
- 49) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 28 datë 27.05.2010
- 50) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 9 datë 23.03.2010
- 51) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 52 datë 05.12.2012
- 52) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 25.07.2013
- 53) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.1 datë 06.02.2013
- 54) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 56 datë 27.07.2016
- 55) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11 datë 09.03.2021
- 56) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 21 datë 22.04.2025
- 57) Degenhart C., Staatsrecht I, Botuar nga CF Muller Verlag, Gjermani, 1998.
- 58) https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_25_1223